



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.17, datë 24.01.2022

PËR

PËR CAKTIMIN ME SHORT TË RELATORIT PËR PROCEDURËN E VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS PËR KANDIDATËT QË KANË KANDIDUAR PËR POZICION DREJTUESI, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 220, DATË 29.06.2021, TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në nenet 159, pika 2, 190, pika 2, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikat 2-7, të nenit 32, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në pikën 2, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit nr. 171, datë 27.09.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për miratimin e Rregullores për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, i ndryshuar, në nenin 9, pika 4, të Vendimit nr. 200, datë 23.09.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për miratimin e rregullores mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, si dhe me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale,

VENDOSI:

1. Për caktimin me short të relatorit për procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë kandiduar për pozicion drejtuesi, të shpallur me Vendimin nr. 220, datë 22.06.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:
 - Durim Bedini kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë
Relator z. Ludovik Doda
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR

GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR

ALFRED BALLA



ANËTAR
SOKOL STOJANI



ANËTAR
BUJAR SHESHI



ANËTAR
NURIHAN SEITI



ANËTAR
ELOIDA GOXHI



ANËTAR
ESMERALDA KESHI



ANËTAR
LUDOVIK DODAJ



ANËTAR
ZEQIR HODA



ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
TARTAR BAZAJ